

Agjensia: _____

TRAVELERS OF MASSACHUSETTS

Këshillim Kundër Keq Informimit me Qëllim për të Mashtruar Kompaninë e Sigurimit

E kuptoj që në rast se jap informacion fallco ose të paplote në një aplikim për sigurimin e makines, kompania e sigurimit mund të refuzojë të paguaj disa kërkesa (çështje) që rezultojnë si pasojë e një aksidenti automobilistik, dhe unë (personi i siguruar) do të jem i përgjegjshëm për të dëmshpërblyer kompaninë për shumën që i është paguar një personi ose grupi të pafajshëm.

Disa shëmbuj që përfshijnë informacion fallco ose mashtrues janë:

1- Mos informimi në rastin kur:

Një person i cili do të ngasë makinën nuk ka patentë.
Makina nuk është e regjistruar brenda rregullave dhe ligjeve të shtetit të Massachusetts.
Aplikanti ose personi i cili zakonisht nget makinën e siguruar nuk ka paguar shumën e caktuar e cila duhet paguar menjëherë ose gjatë periudhës së një viti kalendarik

2- Informacioni fallco ose jo i plote në lidhje me:

Shoferat e përhershëm të makinës.
Vendi ku parkohet makina rregullisht gjatë natës.
Numri i miljeve të konsumuara gjatë një viti kalendarik.
Vërtetime fallco për eksperiencën si shofer(e) të marra jashtë Amerikës.
Paisjet e sigurimit që përmban makina.
Paisjet e ndryshme të alarmit për mos vjedhjen e makinës.

Mashtrimi i Kompanisë së Sigurimit është Krim

E kuptoj që dhënia e informacioneve fallco tek kompania e sigurimit të automjeteve gjatë procesit të aplikimit për sigurimin e makinës, me qëllim përfitimi, konsiderohet krim dhe dënohet me burgim për një kohë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj, me gjobë jo më pak se \$1000.00 ose të dyja bashkë.

Njëkohësisht, dënohen me ligj edhe ata persona të cilët me ndërgjegje ndihmojnë në dhënien e informacioneve fallco dhe jo të plota.

Çdo person i dënuar për mashtrim të kompanisë të sigurimit, është njëkohësisht i detyruar të paguajë edhe dëmet financiare që i ka shkaktuar kësaj kompanie.

Unë e kam lexuar dhe e kam kuptuar materialin e mësipërm.

Nënshkrimi i Aplikantit

Data e Firmosjes

Emri i Aplikantit
(Me shkronja shtypi)

Numri i Sigurimit